

CHAMPION 50

PRODUKT PËR MBROJTJEN E BIMEVË



GHS09



GHS05



GHS07

FJALË SINJALIZUESE RREZIK

“Lexo fletudhëzuesin para përdorimit”

CHAMPION 50 është fungicid-baktericid bakri me veprim kontakti, që përdoret në shumë kultura bujqesore dhe për kontrollin e një numri të konsiderueshëm semundjesh kerpudhore dhe bakteriale.

Lënda vepruese: 77 % hidroksid bakri, ekuivalent me 50 % të bakrit metalik

Formulimi: Granula të dispergueshme në ujë (WG)

Masat parambrojtëse:

- Ruajeni në vende të thata dhe të freskëta, larg ushqimeve dhe pijeve për njerëzit si dhe ushqimeve për blegtorinë.
- Evitoni marrjen e preparatit me organet e frymëmarrjes gjatë përgatitjes së solucionit spërkatës dhe gjatë spërkatjes.
- P264: Lani duart menjëherë me ujë të bollshëm.
- P270: Gjatë përdorimit mos pini, mos hani dhe mos pini duhan.
- P101: Nëse është e nevojshme këshilla mjekësore, keni kontejnerin e produktit ose etiketën në dispozicion.
- P102: Mbani larg mundësive të fëmijëve.
- P103: Lexoni etiketën përpara përdorimit.
- P280: Vishni doreza mbrojtëse/veshje mbrojtëse/mbrojtje të syve/mbrojtje të fytyrës.
- P501: Hidhni përmbajtjen/enën në përputhje me rregulloret në fuqi.
- EUH401: Për të shmangur rreziqet për shëndetin e njeriut dhe mjedisin, respektoni udhëzimet e përdorimit.
- P391: Mblidhni dhe pastroni rrjedhjet.

Udhëzime për ndihmën e parë dhe këshilla për mjekun:

- H302: I dëmshëm nëse gëlltitet. P301+P312-NESE GËLLTITET: Thirrni një Qendër Antihelmimi ose mjek nëse ndiheni jo mirë.
- H332: I dëmshëm nëse thithet nga hundët.
- P312: Nëse nuk ndiheni mirë: Kërkoni menjëherë ndihmë mjekësore ose telefononi një mjek ose qendrën e helmimeve.
- **Helmimi nga thithja me hundë:** Nëse simptomat vazhdojnë edhe pas largimit nga burimi i ndotjes ose edhe pas nxjerrjes në ajër të pastër kërkoni menjëherë kujdesin mjekësor.
- **Kontakti me lëkurën:** Largoni menjëherë të gjithë rrobat e ndotura. Lahuni në pjesët e ndotura menjëherë me ujë të rrjedhshëm, dhe sapun për të paktën 15min. Merrni kujdesin mjekësor. Telefonojini menjëherë mjekut ose qendrës së helmimeve. Lani veshjet e ndotura përpara ripërdorimit.
- **Në kontakt me sytë** P305+P351+P338: Lani sytë menjëherë për rreth 15 minuta me ujë të rrjedhshëm, me qepallat hapur. Mos harroni të hiqni lentet e kontaktit. Merrni menjëherë kujdesin mjekësor.
- **Gëlltitja:** Në rast gëlltitje aksidentale merr menjëherë kujdesin mjekësor. Tregoni etiketën. Kontrolloni frymëmarrjen. Bëni frymëmarrje artificiale. Mbajeni në gjendje qetësie, kontrolloni temperaturën e trupit. Nëse pacienti është i pa vetëdijshëm, mbajeni në pozicion të shtrirë anash dhe me gjunjë të përthyer, mos i jepni asgjë nga goja. P310-Thirrni menjëherë një Qendër Antihelmimi ose mjek.

- **Terapia:** Lavazhi i stomakut me tretësirë a-laktalbumin, në rast të cupraemisë së lartë përdorni komponime të ligandeve, penicilaminë nëse rruga me gojë është CaEDTA e zbatueshme ose intravenoze dhe BAL intramuskulare; për pjesën tjetër të trajtimit simptomatik.
- Si antidot përdoret Penicilamina.

Përdorimi:

Ne vreshta, kunder vrugut dhe kalbezimit të zi, me 2–3 kg/ha, në 1000-2000 lit uje, duke filluar pas lulezimit e deri në vjelje.

Ne farore (molle, dardhe), kunder kromes, zjarrit bakterial, kancerit të degeve (*Nectria galligenae*, *Phomopsis mali*, *Sphaeropsis malorum*, *Pseudomonas syringae*), në trajtimet dimerore duke filluar me renien e gjetheve e deri në fryrje të sytheve, me 2–3 kg/ha, në 1000-2000 lit uje. Kunder *Phytophthora cactorum* përdoret me përqendrim 0.23 %, duke përdorur 15 lit solucion për rrenje, të shpërndarë në bazen e bimes.

Ne berthamore (kajsi, kumbull, bajame, qersh, pjeshke), për trajtimet dimerore, kunder gjethe përdredhese, gjethe birueses, me 3–4 kg/ha, në 1000-2000 lit uje.

Ne agrume, kunder malsekos, tymthit, fitoftores, antraknozës, me 2–3 kg/ha, në 1000-2000 lit uje, duke trajtuar para dhe pas lulezimit.

Ne ullinj, kunder syrit të Palloit, tymthit, me 2–3 kg/ha, në 1000-2000 lit uje, duke trajtuar në fillim të tetorit dhe duke vazhduar pas vjeljes dhe pas krasitjes.

Ne patate, kunder vrugut dhe alternaries, me 2–3 kg/ha, në 400-600 lit uje, duke filluar trajtimet kur bimët kanë arritur lartësinë e 15 cm.

Ne domate, kunder vrugut, alternaries, septoriozës, me 2–3 kg/ha, në 500-1000 lit uje, duke trajtuar çdo dhjetë ditë, në vartësi të kushteve klimatike që favorizojnë zhvillimin e këtyre semundjeve. Kunder syrit të zogut (*Corynebact. michiganense*), njollosjes nekrotike bakteriale (*Pseudomonas syringae*), njollosjes së zeze bakteriale (*Xanthomonas campestris*), duke trajtuar në intervale të rregullta çdo 10-15 ditë.

Ne perime të tjera (fasule, bizele, laker, lulëlaker, karote, finok), kunder vrugjeve, antraknozave, septoriozave dhe bakteriozave, me 2–3 kg/ha, në 400-600 lit uje.

Ne pjepër, trangull, kunder vrugut dhe antraknozës, me 2–3 kg/ha, në 500-1000 lit uje, duke trajtuar çdo 10-15 ditë, në vartësi të zhvillimit të semundjes.

Vërejtje për përdorimin:

Perzihet me insekticidet dhe fungicidet me përdorim të zakonshëm, me përjashtim të atyre me reaksion alkaline. Nuk duhet përdorur gjatë lulezimit.

Fitotoksiciteti:

Nuk duhet përdorur gjatë lulëzimit. Në pjeshket, nektarinat, kajsite dhe disa varietete mollesh (Abbondanza, Black Stayman, Golden Delicious, Gravenstein, Jonathan, Beauty, Morgenduft, Stayman, Stayman Red, Stayman Winesap, Black Ben Davis, King David, Reneta del Canada, Rosa Mantovana) dhe dardhet (Abate Fetel, Buona Luigia, d'Avranches, Butirra Clairgeau, Passacrassan, B.C Williams, Dott. Jules Guyot. Favorita di Clapp, Kaiser, Butirra Giffard), produkti mund të jetë fitotoksik nëse përdoret në vegjetacion të plote; në keto raste keshillohet të përdoret kur vegjetimi i bujeshëm i bimes fillon të bjere. Megjithatë, në rastet kur trajtimi drejtohet kundër bakteriozave, fitotoksiciteti kthehet në një problem sekondar dhe trajtimet duhet të kryhen siç përmendet në këto etikete, në rubrikat e më sipërme.

Ndikimi në ekosistem:

H400: Shumë toksik për jetën ujore.

H410: Shumë toksik për jetën ujore me efekte të gjata.

Rrelativisht helmues për bletet.

I dëmshëm për blegtorinë, prandaj evitoni kullotjen e tyre në zonat e trajtuara me këtë produkt.

Karenca:

Trajtimi fundit para vjeljes: Në domate 8 ditë; në hardhi dhe farore 15 ditë; për të gjitha kulturat e tjera 20 ditë.

Magazinimi:

Ruajeni në ambalazhin origjinal, në vende të thata, të ajrosura e të pa ekspozuara nga drita direkte e diellit, në temperaturë 0-35⁰ C.

Nr dhe data e regjistrimit: 239/1, date 6.2.2020;

Sasia neto e PMB-se, që ndodhet në ambalazhin baze: deri 10 kg.

Data e prodhimit..... ;

Data e skadencës ose periudha e ruajtjes (sipas kërkesëve të përcaktuara): 4 vjet;

Numri i partise së mallit (serise) ose shenja të tjera identifikuese ;

Tipi i ambalazhit baze: Material i pa përshkueshëm nga lagështia (tre shtresor).

Emri dhe adresa e Aplikantit: Nufarm SAS. **Adresa:** Gennevilliers, France.

Emri dhe adresa e fabrikuesit të PMB-se: Nufarm SAS. **Adresa:** Gennevilliers, France. Fabrikimi: Quimetal Industrial SA. **Adresa:** Santiago, Chili.

Emri dhe adresa e ambalazhuesit (kur ambalazhi kryhet në Republikën e Shqipërisë):